



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15915 Prot

Lezhë, më 26 / 09 /2022

VENDIM

Nr. 101, Datë 23 . 09 .2022

Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e përdorimit të Fondit të Kontigjencës në shumën 30,000 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022, për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet : Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.609 për shumën 30,000 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.10430, Kap.01, Art.606 për shumën 30,000 lekë, fond i cili do të përdoret për dhënie ndihmë financiare të 1 familjeje për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të varrimit të të ndjerës Floresha Berishaj.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

CP.
Nr. 15815/prot
Dt. 29.9.2022

Nr. 682/2 Prot.

Lezhë, më 28.09.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 101, datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për përdorimin e fondit të kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022”.

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

